




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje

Department for Education



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA



Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

-IV-

Nr. i prot.

Br. prot.

187

Më

Dt.

24.06.2019

RAHOVEC - ORAHOVAC

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN SHKOLLOR 2019/2020

(afati i qershorit)

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollës profesionale, për vitin shkollor 2019/20, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nistifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe në shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet në datat, 24, 25 dhe 26 qershor 2019 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën, 28 qershor 2019.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 29 qershor 2019.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|--|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (25%) 25 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare në test | (15%) 15 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (60%) 60 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari gjindet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (p.sh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet më mesataren e notave të kl. 6 – 9 të $(5+5+5+5) = 20$; $20 : 4 = 5$)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë ,në këtë rast vlera e fituar pjestohet me 2 dhe shumëzohet me 3.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjimnazi i shkencave natyrore** - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare ,në test (10 pikë nga lëndët: fizikë,kimi, dhe biologji),ky kriter vlenë edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjekësisë.

$$\text{p.sh për tri lëndë: } \frac{\text{Kimi (3)} + \text{Biologji (4)} + \text{Fizikë (5)}}{3} = \frac{3 + 4 + 5}{3} = \frac{12}{3} = 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore**-Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe,gjuhë angleze,histori,gjeografi,edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4(katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët, gjuhë shqipe,gjuhë angleze, histori dhe gjeografi).

Për kushtee tjera specifike për drejtime dhe profile të caktuara më gjerësishtë mund të informoheni në qendrat e regjistrimit në shkollat ku dëshironi të regjistroheni.

**PLANIFIKIMI I REGJISTRIMIT TË NXËNËSVE NË KLASAT (10-ta) PER VITIN
SHKOLLOR 2019/20, AFATI I QERSHORIT**

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
1	SHML"Xhelal Hajda-Toni	Rahovec	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	6	32	192
			Gjimnazi i Shkencave Shogërore	2	32	64
			Gjithësejtë:	8		256

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
2	SHML"Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	32	96
			Gjimnazi i Shkencave Shogërore	2	32	64
			Makineri:			
			Automekanik-1	1	28	28
			Ekonomi:			
			Kontabilist-1	1	28	28
			Gjithësejtë	7		216

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
3	SHML"12 Maji"	Ratkoc	Gjimnazi i Shkencave Natyrore	3	32	96
			Gjimnazi i Shkencave Shogërore	2	32	64
			Makineri:			
			Automekanik-1	1	28	28
			Ekonomi:			
			Kontabilist-1	1	28	28
			Gjithësejtë	7		216

Nr.	Emri i shkollës	Vendi	Drejtimi	Numri i paraleleve	Nr. i nxënësve në klasë	Gjithësejtë nr. i nxënësve
4	SHMLP"Selajdin Mullaabazi-Mici"	Rahovec	Ekonomi: Kontabilistë-1	1	28	28
			Hoteleri: Asistent Restoranti-1	1	28	28
			Juridik : Asistent Juridiku -1 Asistent i Administratës -1	2	28	56
			Makineri: Automekanik -1	1	28	28
			Ndërtimtari: Gjeodezi -1	1	28	28
			Tek.Ushqimore : Përpunim i prodhimeve ushqimore -1	1	28	28
			Shëndetësi: Teknik i dhëmbëve -1	1	25	25
			Elektro: Instalues i rrymës elektrike -1	1	28	28
			Gjithësejtë	9		249

Gjithësejtë për komunën e Rahovecit	31		937
--	-----------	--	------------

Rahovec më:
24.06.2019



Avni Morina, Drejtor

[Signature]